



Në mbështetje të nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me nenin 4.8 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore Ligji Nr. 02/L-88, me qëllim të përcaktimit të rregullave të organizimit, procedurave të punës dhe funksioneve të KKTK-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 12 maj.2016, Bordi i KKTK miratoj:

KËSHILLI I KOSOVËS
PËR TRASHËGIMI KULTURORE
PRISHTINË

Nr. 17/16 dt. 12.5.2016

RREGULLORE NR 01/2016
PËR PUNËN E KËSHILLIT TË KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE

NENI 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1.1. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) është agjenci e pavarur e krijuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore ku i ka të përcaktuara kompetencat dhe përgjegjësit e tij.

NENI 2

PËRKUFIZIMET

- 2.1. “Bordi” shtatë (7) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- 2.2. “Sekretariati” shërbyesit civil që punojnë në kuadër të KKTK-së;
- 2.3. “Komisione të pavarura” komisione të pavarura që krijohen nga Bordi i KKTK-së, për çështje të ndryshme të përcaktuara më Ligj dhe Rregullore.

NENI 3

MISIONI DHE VEPRIMTARIA

- 3.1. Misioni i KKTK-së është vlerësimi dhe shpallja e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, si dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore duke respektuar të gjitha normat dhe standardet ndërkombëtare;
- 3.2. KKTK veprimtarin e vet e zhvillon në mënyrë të pavarur, profesionale dhe pa ndikime nga jashtë.

NENI 4

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË

Kompetencat dhe përgjegjësit e KKTK-së janë:

- 4.1. Shqyrton, vlerëson, aprovon apo refuzon trashëgiminë kulturore të propozuar për shpallje në mbrojtje të përhershme;
- 4.2. Propozon hartimin e Politikës Nacionale për Trashëgimi Kulturore;
- 4.3. Vlerëson projektet e propozuara të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse;
- 4.4. Asiston Kuvendin e Republikës së Kosovës në plotësim – ndryshimet e ligjeve që kanë të bëjnë me trashëgimi kulturore;
- 4.5. KKTK, siguron mjete apo donacione për intervenime dhe çështje të tjera në trashëgimi kulturore;
- 4.6. KKTK, themelon Komisione të pavarur për vlerësimin e kompensimit të asetet në rast shitblerje, shpronësimi apo për ndonjë humbje financiare që ka ndodhur në asetet e evidentuara që kanë karakter të mbrojtjes së përkohshme ose përhershme. Kjo do të rregullohet me një akt të veçantë në pajtim me këtë rregullore;
- 4.7. KKTK mbikëqyr Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) gjatë hartimit të listës së aseteve të trashëgimisë kulturore në rrezik;
- 4.8. Identifikon dhe i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës prioritetet vjetore për mbështetje financiare të trashëgimisë kulturore;
- 4.9. I propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës ndërmarrjen e masave të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në Republikën e Kosovës nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria;
- 4.10. Bashkëpunon me MKRS dhe Institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si UNESCO, Këshilli i Evropës etj, për çështje të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore

në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin për Trashëgimi Kulturore, ligjet e tjera në fuqi si dhe konventat dhe standardet ndërkombëtare;

4.11. Bashkëpunon me Këshillin Zbatues dhe Monitorues (KZM) mbi çdo çështje që ka lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës sipas Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;

4.12. Rivlerëson apo rishikon Qendrën e mbrojtur historike të Prizrenit me të gjitha elementet e saj, bazuar në Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

NENI 5

SELIA E KKTK

5.1. Selia e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është e vendosur në Prishtinë.

NENI 6

VULA DHE SIMBOLI I KKTK

6.1. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore ka vulën dhe simbolin e vet identifikues;

6.2. Përmbajtja dhe forma e vulës përcaktohet me vendim të Bordit, në përputhje me ligjin për vulat e institucioneve;

6.3. Përmbajtja dhe forma e simbolit përcaktohet me vendim të Bordit, në përputhje me ligjin për simbolet shtetërore;

NENI 7

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KKTK

7.1. Struktura organizative e KKTK-së përbëhet nga:

7.1.1. Bordi;

7.1.2. Sekretariati.

NENI 8

BORDI I KKTK

8.1. Bordi i KKTK përbëhet nga shtatë (7) anëtarë;

8.2. Mandati i anëtarëve të Bordit është tre (3) vjeçar;

- 8.3. Anëtarët e Bordit të KKTK-së zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të procedurave të parapara më ligj;
- 8.4. Mandati i anëtarëve të Bordit zgjatet deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj.

NENI 9

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E BORDIT

- 9.1. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe nënkryetaret e KKTK-së;
- 9.2. Përcakton trashëgiminë kulturore në mbrojtje të përhershme;
- 9.3. Miraton buxhetin e KKTK-së;
- 9.4. Miraton planin e punës të KKTK-së;
- 9.5. Miraton të gjitha vendimet e KKTK-së;
- 9.6. Themelon komisione të pavarura për çështje të ndryshme të trashëgimisë kulturore dhe KKTK-së;
- 9.7. Miraton raportin e punës vjetor të KKTK-së;
- 9.8. Nxjerr akte nënligjore dhe shkresa të tjera;
- 9.9. Formon grupe punuese për kryerjen e detyrave të caktuara;
- 9.10. Zgjedh dhe shkarkon Udhëheqësin Ekzekutiv të KKTK-së, sipas procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi;
- 9.11. Vlerëson punën dhe performancën e Udhëheqësit Ekzekutiv të KKTK-së;
- 9.12. Në raste të veçanta mbikëqyrë mbarëvajtjen e punës së Sekretariatit.

NENI 10

ZGJEDHJA E KRYETARIT TË KKTK

- 10.1. Mënyra e propozimit dhe zgjedhjes së Kryetarit:
- 10.1.1. Sicili anëtar i Bordit ka të drejtë të propozojë veten ose një anëtar tjetër për Kryetar;
- 10.1.2. Zgjedhja e Kryetarit mund të jetë më vota të hapura ose të mbyllura;
- 10.1.3. Kryetar i KKTK do të zgjedhet ai/ajo që merr shumicën e votave sipas nenit 13.10 të kësaj Rregullore;
- 10.2. Kryetari i KKTK ka mandat tre (3) vjeçar;
- 10.3. Kryetari për punën e KKTK i përgjigjet Bordit dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

NENI 11

PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT TË KKTK

- 11.1. Organizon dhe udhëheqë punën e përgjithshme të KKTK-së;
- 11.2. Thërret dhe kryeson të gjitha takimet e KKTK-së;
- 11.3. Përfaqëson KKTK-në para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- 11.4. Autorizon shfrytëzimin e buxhetit, sipas planit të aprovuar nga Bordi i KKTK-së;
- 11.5. Nënshkruan vendimet dhe të gjitha aktet e tjera të miratuara nga Bordi i KKTK-së;
- 11.6. Informon anëtarët e Bordit për punën e vet dhe të KKTK-së.

NENI 12

NËNKRYETARET E KKTK

- 12.1. KKTK ka dy (2) nënkryetar;
- 12.2. Nënkyetaret zgjedhën dhe shkarkohen nga bordi i KKTK-së;
- 12.3. Propozimi i nënkryetarëve të parë të dytë dhe të tretë bëhet nga Kryetari dhe zgjedhën më shumicë votash nga Bordi sipas rotacionit;
- 12.4. Mandati i nënkryetarëve është një (1) vjeçar pa mundësi rizgjedhje;
- 12.5. Nënkyetari kryeson mbledhjet dhe takimet e KKTK-së, në mungesë të Kryetarit;
- 12.6. Detyra të tjera të deleguara nga Bordi i KKTK-së;

NENI 13

MBLEDHJET E BORDIT

- 13.1. Kryetari paraprak e thërret mbledhjen e parë për konstituimin e KKTK, më së voni 30 ditë nga dita e emërimit të anëtarëve të Bordit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- 13.2. Në mungesë të Kryetarit paraprak, Sekretariati do të kujdeset për të thirrur mbledhjen e parë konstituive;
- 13.3. Në mbledhjen e parë të Bordit të KKTK-së, zgjedhet kryetari dhe dy (2) nënkryetarët;
- 13.4. Bordi i KKTK-së mban mbledhje të rregullta të punës së paku dy (2) herë në muaj;
- 13.5. Anëtarët e Bordit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje, përveç në rastet e arsyetuara;
- 13.6. Mbledhjet i thërret dhe drejton kryetari i KKTK-së. Në mungesë të Kryetarit mbledhjet drejtohen nga njëri nga Nënkyetaret;
- 13.7. Rendi i ditës propozohet nga kryetari apo anëtarët e Bordit;

- 13.8. Rendi i ditës miratohet me votat e shumicës së anëtarëve prezent në mbledhje;
- 13.9. Nevojitet që shumica e anëtarëve të Bordit të jenë të pranishëm në mbledhje për të arritur kuorumin;
- 13.10. Për të gjitha vendimet e KKTK-së, nevojitet shumica e votave të të gjithë anëtarëve të Bordit të KKTK-së;
- 13.11. Vota e secilit anëtarë është e barabartë dhe mund të votojë “pro”, “kundër” dhe “abstenim”;
- 13.12. Në raste kur votat janë të barabarta, atëherë votimi mund të përsëritet në atë mbledhje ose të shtyhet për një mbledhje tjetër të Bordit;
- 13.13. Votimi në mbledhjet e Bordit është i hapur, përveç në raste kur Bordi vendos për votim të fshehtë;
- 13.14. Kryetari i KKTK-së sipas rasteve mund të thërras edhe mbledhje të jashtëzakonshme;
- 13.15. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret edhe me propozimin e nënshkruar të së paku tre (3) anëtarëve të Bordit;
- 13.16. Mbledhjet e Bordit në aspektin teknik dhe administrativ organizohen nga Sekretariati i KKTK-së;
- 13.17. Me propozim të anëtarëve të Bordit, nëpunësit e Sekretariatit mund të marrin pjesë në mbledhje;
- 13.18. Në mbledhjet e Bordit mbahet procesverbali;
- 13.19. Për përgatitjen e procesverbalit, ruajtjen dhe mbajtjen e tij, përgjegjës është Sekretariati i KKTK;
- 13.20. Në procesverbal mbahet shënim i saktë i të gjitha diskutimeve përgjatë mbledhjes së Bordit ku përfshihen:
- 13.20.1. Data, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes;
 - 13.20.2. Emrat e pjesëmarrësve dhe cilësinë e tyre në mbledhje;
 - 13.20.3. Rendin e ditës;
 - 13.20.4. Përmbajtjen e diskutimeve;
 - 13.20.5. Procedurën e votimit, nëse ka mendime të veçanta të përfshihen arsyetimet;
 - 13.20.6. Vendimin e Bordit;
- 13.21. Në procesverbalet e mbledhjes të Bordit shënohen në mënyrë të qartë vendimet, personi, departamenti ose divizioni përgjegjës për zbatimin e vendimit dhe afati i përcaktuar kohorë nëse nevojitet;
- 13.22. Procesverbali i mbledhjes mund të incizohet;

13.23. Procesverbali së bashku më ekstraktin aprovohet nga Bordi në mbledhjen e ardhshme të tij dhe nënshkruhet nga Kryetari.

NENI 14

HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT TË BORDIT TË KKTK

- 14.1. Skadimin e kohës së rregullt për të cilën është emëruar, deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj;
- 14.2. Nëse është dënuar për vepër penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg;
- 14.3. Dorëheqje;
- 14.4. Paaftësisë mentale apo fizike për të kryer detyrat e anëtarit të Bordit;
- 14.5. Mungesës në punë në tri (3) mbledhje radhazi pa arsye;
- 14.6. Shkarkimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

NENI 15

SEKRETARIATI

- 15.1. Në kuadër të KKTK-së funksionon Sekretariati, si organ mbështetës profesional, administrative dhe teknike për nevoja të KKTK-së, i cili përbëhet nga nëpunës civil që kanë detyra të caktuara në përmbushjen e përgjegjësiave dhe mandatit që ka KKTK;
- 15.2. Detyrat, përgjegjësitë, organizimi dhe sistematizimi i vendeve të punës do të përcaktohen më rregullore të veçantë të nxjerrë nga Bordi;
- 15.3. Sekretariati udhëhiqet nga Udhëheqësi Ekzekutiv;
- 15.4. Ofron shërbime profesionale dhe këshilluese për Bordin, për të mundësuar një vendim marrje të drejt;
- 15.5. Përgatit propozimin për buxhetin vjetor të KKTK-së të cilin ia paraqet Bordit për miratim;
- 15.6. Sigurimin e shërbimeve mbështetëse lidhur me organizimin dhe zhvillimin me sukses të takimeve të Bordit dhe takimeve të tjera;
- 15.7. Përgatit dokumente dhe materialeve sipas nevojave të punës dhe kërkesave të Bordit;
- 15.8. Zhvillon shërbimet e ndërlidhura me planifikimin, rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore;
- 15.9. Planifikimin dhe shpenzimet buxhetore, si dhe kryerjen e pagesave të KKTK në përputhje me procedurat ligjore;

15.10. Ofron shërbime të tjera mbështetëse, të cilat me vendime të posaçme kërkohen nga Bordi;

15.11. Sekretariati përbëhet nga Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Departamenti për Peizazhe Kulturore, Departamenti i Gjeobazës, Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme, Departamenti i Buxhetit dhe Financave, Divizioni për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshme, Divizioni për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Luajtshme, Divizioni i Burimeve Njerëzore.

NENI 16

UDHËHEQËSI EKZEKUTIV

16.1. Udhëheqësi Ekzekutiv zgjedhët dhe shkarkohet nga Bordi i KKTK-së, sipas procedurave të parapara më legjislacionin në fuqi;

16.2. Udhëheqësi Ekzekutiv drejton Sekretariatit e KKTK-së;

16.3. Udhëheqësi Ekzekutiv i përgjigjet drejtpërdrejtë Bordit të KKTK-së;

16.4. Bordi i KKTK-së vlerëson performancën e Udhëheqësit Ekzekutiv në bazë të procedurave ligjore në fuqi për shërbimin civil;

16.5. Vlerësimi bëhet më shkrim nga të gjithë anëtarët e Bordit të KKTK-së, bazuar në format standarde të vlerësimit;

16.6. Mandati i Udhëheqësit Ekzekutiv zgjatë 3 (tre) vjet, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat.

NENI 17

VLERËSIMI DHE SHPALLJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

17.1. KKTK e ka në mandat vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, siç përcaktohet në Ligjin për Trashëgimi Kulturore dhe ligjet e tjera relevante;

17.2. Për përcaktimin e procedurave, kritereve të vlerësimit dhe shpalljes, punën në teren, Bordi i KKTK-së do të nxjerrë akte të veçanta.

NENI 18

KOMISIONET E PAVARURA TË KRIJUARA NGA KKTK

- 18.1. Bordi i KKTK do të themelojë komisione të pavarura dhe grupe punuese për çështje të veçanta;
- 18.2. Mënyra e funksionimit, përgjegjësit dhe kompensimi do të rregullohet me akte të veçantë të nxjerra nga Bordi i KKTK-së;
- 18.3. Anëtar të këtyre komisioneve dhe grupeve punuese do të jenë anëtarët e Bordit, nëpunësit e Sekretariatit të KKTK-së, si dhe ekspert të jashtëm.

NENI 19

BUXHETI DHE FINANCIMI I KKTK

- 19.1. KKTK financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
- 19.2. KKTK ka kodin e vetë buxhetore të cilën e administron në mënyrë të pavarur, përmes të cilës zhvillon aktivitetet e veta të rregullta vjetore;
- 19.3. KKTK mund të marr donacione nga donatorët në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ato nuk duhet të ndikojnë në pavarësinë e KKTK-së. Për donacionet që pranohen, duhet të njoftohet Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera përgjegjëse;
- 19.4. Paga e anëtarëve të Bordit të KKTK-së, deri në aprovimin e Ligjit për Pagat e Funkionarëve Publik, përcaktohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- 19.5. Pagat për nëpunësit e Sekretariatit janë të rregulluar më Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil;
- 19.6. Bordi i KKTK-së mund të merr vendim për pagesa shtesë / kompensim mbi pagën bazë për punonjësit e KKTK-së, bazuar në legjislacionin në fuqi.

NENI 20

RAPORTIMI

- 20.1. KKTK për punën e vet duhet të raportoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës si themelues të paktën një (1) herë në vit;
- 20.2. KKTK mund të raportoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës në bazë të kërkesave të tij.

NENI 21

TRANSPARENCA DHE GJUHËT E PËRDORURA TË PUNËS NË KKTK

- 21.1. Komunikimi me media dhe opinionimi në emër të KKTK-së e bënë Kryetari ose ndonjë anëtarë ose punonjës i KKTK-së i autorizuar nga Bordi;
- 21.2. Gjuhët që përdoren në punën e KKTK-së janë gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës;
- 21.3. Për të gjitha mbledhjet e KKTK-së, sipas nevojës, Sekretariati siguron përkthim në gjuhët e punës në mënyrë simulantë ose konsektive.

NENI 22

NDRYSHIMI I RREGULLORES SË PUNËS SË KKTK-SË

- 22.1. Kjo Rregullore mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të Bordit;
- 22.2. Për të ndryshuar këtë Rregullore nevojiten 2/3 e votave të anëtarëve të KKTK-së.

NENI 23

HYRJA NË FUQI

- 23.1. Kjo Rregullore e Punës hyn në fuqi ditën kur miratohet nga Bordi i KKTK-së dhe shfuqizon Rregulloren e mëparshme të Punës dhe Statutin e KKTK-së;
- 23.2. KKTK është e obliguar që në afat prej 6 muajsh nga dita e miratimit të kësaj Rregullore, të nxjerrë të gjitha aktet që burojnë nga kjo Rregullore.

Kryetari i KKTK-së



Shafi Gashi

Më 12 maj 2016